

VENDIM
Nr. 799, datë 12.12.2022

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 87, DATË 9.2.2022, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR
FINANCIMIN E RIKONSTRUKSIONIT/RIPARIMIT TË MJEDISEVE NË
BASHKËPRONËSI OSE TË PËRBASHKËTA NË NDËRTESA (PALLAT), NË
BASHKINË MIRDITË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarja “i”, dhe 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 115/2021, ‘Për buxhetin e vitit 2022’, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 2, të vendimit nr. 87, datë 9.2.2022, të Këshillit të Ministrave, shtohet pika 2/1, me këtë përmbajtje:

“2/1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, në masën 210 393 360 (dyqind e dhjetë milionë e treqind e nëntëdhjetë e tre mijë e treqind e gjashtëdhjetë) lekë, për financimin e rikonstruksionit/riparimit të mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa (pallat), në Bashkinë Mirditë, i cili përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit miratuar, për vitin 2022, dhe i transferohet Bashkisë Mirditë, në formën e transfertës së pakushtëzuar.”.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Mirditë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku